


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Mars 2017

Tiranë, më 10 Prill 2017: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Mars 2017, arriti 104,7 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Në muajin Mars 2017 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 2,1 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 0,3 %.


Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit. Rritja vjetore e çmimeve në muajin Mars është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me + 1,43 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me +0,23 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me +0,22 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,16 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim e kulturë” kanë kontribuar me +0,08 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Shërbimi arsimor” dhe “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar respektivisht me + 0,03 dhe +0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Mobilje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje” kanë kontribuar respektivisht me -0,03 dhe -0,01 pikë përqindje.

Për publikim 10/04/2017

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Mars 2016, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Transporti” me 3,8 %, pasuar nga grupet “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,4 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3,3 %, “Argëtim dhe kulturë” me 3,2 %, “Shërbimi arsimor” me 0,7 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate, përfshirë patatet” u rriten me 12,3 %, pasuar nga nëngrupet “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” me 5,3 %, “qumësht, djath e vezë” me 5,2 %, “fruta” me 3,7 % etj . Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “vajra dhe yndyrna” u ulën me 1,6 % dhe “peshk” me 0,1 %.

Ndryshimi mujor i indeksit është + 0,4 %. Krahasuar me muajin Shkurt 2017 rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Transporti” me 1,0 % pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije jo alkoolike” dhe “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me nga 0,5 % secili, grupi “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,3 % etj. Ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Mobilje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje” me -0,2 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100 %

Kodi	Grupet	Peshat	03-16	04-16	05-16	06-16	07-16	08-16	09-16	10-16	11-16	12-16	01-17	02-17	03-17
	Gjithsej	100,0	102,5	102,0	100,8	100,2	100,2	101,1	101,5	101,2	101,3	102,2	103,7	104,3	104,7
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	40,0	107,0	105,9	102,4	100,4	100,4	102,8	103,1	102,4	101,9	104,6	108,5	110,1	110,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,4	101,2	100,8	100,9	101,0	101,0	100,9	100,9	101,1	100,9	101,3	101,4	101,4	101,7
3	Veshje dhe këpucë	4,0	98,4	98,3	98,4	98,3	98,1	98,1	99,9	100,3	100,6	100,9	99,9	97,6	97,7
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,7	100,7	100,6	100,5	100,4	100,3	100,2	100,4	100,5	101,5	100,9	101,1	101,3	101,8
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,5	100,0	100,3	100,3	100,3	100,5	100,5	100,2	99,6	100,2	100,2	100,3	100,1	99,9
6	Shëndeti	3,0	100,2	100,2	100,0	100,2	100,1	100,0	100,1	100,0	100,2	100,2	100,3	100,3	100,2
7	Transporti	6,2	96,3	96,3	97,2	98,6	99,4	99,8	99,5	99,6	99,5	99,2	99,4	98,9	99,9
8	Komunikimi	2,5	100,3	99,9	99,9	100,0	99,9	99,9	100,5	100,5	100,7	100,6	100,2	100,2	100,2
9	Argëtim dhe kulturë	2,6	100,1	100,2	100,2	100,9	101,7	101,4	101,7	101,2	100,9	102,3	103,3	103,0	103,3
10	Shërbimi arsimor	2,5	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	99,9	100,4	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,9	100,0	100,1	100,1	100,1	100,1	100,1	100,1	100,1	100,0	100,1	100,1	100,2	100,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,7	100,1	100,2	100,3	100,2	100,0	100,4	103,3	103,1	103,1	103,3	103,2	103,2	103,5

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	03-16/03-15	04-16/04-15	05-16/05-15	06-16/06-15	07-16/07-15	08-16/08-15	09-16/09-15	10-16/10-15	11-16/11-15	12-16/12-15	01-17/01-16	02-17/02-16	03-17/03-16
	Gjithsej	0,3	0,3	0,7	1,2	1,9	2,0	1,8	1,5	1,9	2,2	2,8	2,2	2,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,2	2,0	2,3	2,7	4,3	4,7	3,7	3,1	3,2	4,6	5,8	3,9	3,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	2,6	1,7	1,6	1,4	1,7	1,4	1,4	1,6	1,5	1,3	0,9	0,6	0,5
3	Veshje dhe këpucë	-2,3	-2,3	-1,9	-1,5	-1,3	-0,4	1,4	1,0	0,8	0,9	0,6	-0,4	-0,7
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-0,9	0,5	0,5	0,2	0,0	0,0	0,1	0,5	1,5	0,9	0,4	0,6	1,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,7	0,8	0,7	0,9	1,0	0,8	0,8	0,3	0,7	0,2	-0,1	-0,2	-0,1
6	Shëndeti	-2,2	-2,5	-2,8	0,5	0,1	-0,1	-0,2	-0,5	0,2	0,2	0,2	0,2	0,1
7	Transporti	-4,5	-5,3	-4,7	-3,6	-3,3	-2,2	-1,7	-1,5	-0,5	-0,8	2,8	3,2	3,8
8	Komunikimi	-0,7	-1,1	-1,2	-1,0	-1,2	-0,1	0,5	0,5	0,7	0,6	0,2	0,2	-0,1
9	Argëtim dhe kulturë	0,8	0,9	0,8	1,6	2,8	2,4	1,7	1,0	0,8	2,3	3,1	2,8	3,2
10	Shërbimi arsimor	4,8	4,8	4,8	4,8	4,8	4,4	3,8	0,4	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,0	1,1	1,1	1,0	1,0	0,8	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,2	0,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,2	-0,1	-0,1	-0,1	0,1	0,7	2,6	3,0	2,7	3,3	3,2	3,0	3,4

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	03-16	04-16	05-16	06-16	07-15	08-16	09-16	10-16	11-16	12-16	01-17	02-17	03-17
	Gjithsej	0,4	-0,4	-1,2	-0,6	0,1	0,9	0,3	-0,2	0,1	0,9	1,5	0,5	0,4
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	1,1	-1,1	-3,4	-1,9	0,1	2,3	0,3	-0,7	-0,5	2,7	3,7	1,5	0,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,4	-0,4	0,1	0,1	0,0	-0,1	0,0	0,2	-0,3	0,4	0,1	0,0	0,3
3	Veshje dhe këpucë	0,4	-0,1	0,1	-0,1	-0,3	0,0	1,8	0,4	0,3	0,3	-1,0	-2,3	0,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,0	-0,1	-0,1	-0,1	-0,1	0,0	0,2	0,1	1,0	-0,6	0,2	0,2	0,5
5	Mobililje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,3	0,2	0,0	0,0	0,2	0,0	-0,2	-0,6	0,6	0,0	0,1	-0,1	-0,2
6	Shëndeti	0,1	0,1	-0,2	0,2	0,0	-0,2	0,1	-0,2	0,3	-0,1	0,1	0,0	0,0
7	Transporti	0,5	0,0	0,9	1,5	0,8	0,4	-0,3	0,1	-0,1	-0,3	0,2	-0,5	1,0
8	Komunikimi	0,3	-0,4	0,0	0,2	-0,1	0,0	0,6	0,0	0,2	0,0	-0,4	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,0	0,0	0,0	0,7	0,8	-0,3	0,3	-0,5	-0,3	1,4	0,9	-0,3	0,4
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,5	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,1	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,1	0,1	0,1	0,0	-0,2	0,3	2,9	-0,1	-0,1	0,2	0,0	-0,1	0,3

SHPJEGIME METODOLOGJIKE

- Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2015.
- Lista e mallrave dhe shërbimeve është përditësuar, në 332 mallra dhe shërbime nga 333 që ishte në vitin e kaluar.
- Lista e njësive tregtare ku mblidhen çmimet është përditësuar.

- Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve. IÇK në vitin **t** llogaritet me strukturën e shpenzimeve të vitit **(t-1)**

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.